



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:271966
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05474563

C.nr.4740/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Baki Shigjeqi, dhe bashkëpunëtoren profesionale H.D. duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses K.G. me numër personal nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesja ligjore V.I.Xh. nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimi i shujtave, vlera e kontestit 236.00 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, me datë **19.03.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M
Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. APROVOHET** në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses K.G. nga Prizreni, **DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditëses në emër të shujtave ditore për 118 ditë pune për vitin 2022 (për periudhën prej datës 01.01.2022 deri më datën 21.11.2022), ti paguaj **shumën e përgjithshme prej dyqindetridhjetegjashtë euro (236.00 €)**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (07.12.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- II. DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **njëqindnjëzetekatër euro (124.00 €)**, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja K.G. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av.A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate, me datën 07.12.2022, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shujtave.

I autorizuari i paditësit në padi ka theksuar se paditëses i takon kompensimi për shujtat ditore për vitin 2021, nga 2 euro në ditë, për çdo ditë pune, sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për pagesën e shujtave pranë DKA-së, deri më tani nuk kanë marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i kanë propozuar gjykatës që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore të komunës, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 01B/488, të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës

22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar. Po ashtu sipas të autorizuarës së të paditurës përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtarë i sindikatës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënëse në SHFMU “Deshmorët e Kabashit” Komuna e Prizrenit.

Nga vërtetimi me nr. të referencës 138/2023 i datës 13.11.2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU “Deshmorët e Kabashit”, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja K.G. është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2022, dhe atë nga data 01.01.2022 e deri me datë 21.11.2022, ka punuar gjithsej 118 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj pasi vërtetimi është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimit të SHFMU “Deshmorët e Kabashit” Komuna e Prizrenit, gjykata i’a fali besimin e plotë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me vendin e punës dhe ditët e punës, konkretisht paditësja K.G. është mësimdhënëse në SHFMU “Deshmorët e Kabashit” në Prizren, dhe për vitin 2022 nga data 01.01.2022 e deri me datë 21.11.2022, i ka gjithsej 118 ditë pune.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e datës .22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të KKAK-së nr.prot. Nr. 01B/ 105 e datës 22.01.2021 është paraparë se “*Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore*”, ndërsa neni 45 thuhet se “*Nëse nga Kontrata Kolektive pasi t’i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i sajë vazhdon edhe për një vite*”. Në bazë

të nenit të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë mbulohet periudha e kërkesës së paditësit prej 01.01.2022 deri 21.11.2022.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditëses K.G. t'ia paguaj kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë me nr.01/B, nr. prot. 105, e datës .22.01.2021, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht, paditëses, për 118 ditë pune, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 236.00 euro.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 152 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadija e paditëses është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e datës .22.01.2021, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (07.12.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:271966, 19.03.2024

G j y q t a r i

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.